

**Ramiz TAFILAJ**  
**Anëtar i “Bordit Këshillues”**  
**Texas, SHBA.**



Është një sipërmarrës, bamirës aktivist dhe botues shqiptaro-amerikan, i cili gjatë viteve 1990 u bë një nga biznesmenët më me ndikim shqiptaro-amerikan, por edhe një nga veprimtarët më të shquar të çështjes shqiptare. I përkushtuar prej kohësh për çlirimin dhe pavarësinë e Kosovës, ka ndihmuar edhe Shqipërinë në tranzicionin e saj drejt demokracisë në vitet 1990-të. Përveç organizimit të aktiviteteve kulturore në shërbim të afrimit sa më të madh të shqiptarëve me popullin dhe drejtuesit e institucioneve amerikane, ka botuar gjithashtu serinë e suksesshme të librave Kosova, historia e parë gjithëpërfshirëse e Kosovës në llojin e saj, e cila ka ndikuar në situatën e përgjithshme politike në Ballkanin Perëndimor. Humanist i dëshmuar me vepra, i vlerësuar me çmime dhe dekorata të larta, si në Kosovë, Shqipëri dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.